

Date 31.12.2025

Procesverbal - Tipi i kontratës -Shërbim

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

Objekti i procedurës: “Kolaudimi “Shtesa e Impiantit të përpunimit të ujit të pijshëm Bovillë 1800l/s faza e 2 me 1200l/s”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime ndertimi per trajtimin e ujit te pijshem 45252120-5

Vlera e fondit limit : 2.469.353,31 (dy milion e katerqind e gjashtedhjetë e nente mijë e treqind e pesëdhjetë e tre) leke pa Tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 përkatësisht në vlerën : vlerën 49 387,066 (dyzet e nente mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë presje zero gjashtedhjetë e gjashtë) lekë.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2 Kapaciteti ekonomiko-financiar

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 43, pika 1, pika 2 c) neni 55 pika 4, si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”.

2.2.2. Operatori Ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshem gjatë viteve të fundit 2022, 2023, 2024. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të viteve të fundit. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy nga bilancet e kërkuara të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006.

”Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njesitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2025).**

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet të kryera gjatë tri viteve të fundit (përlllogaritur nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës)

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Ose

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën,

prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

2.4 .Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf teknik të përfshirë në licensën e shoqërisë për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit stafi inxhinierik si më poshtë:

- 1(dy) Inxhinier Ndërtimi
- 1(dy) Inxhinier Gjeodet
- 1 (dy) Inxhinier Ndërtimi /Profili Strukturist
- 1(tre) Inxhinier Hidroteknik
- 1(dy) Inxhinier Elektrik
- 1(dy) Inxhinier Mekanik
- 1(dy) Inxhinier Mjedisi nga të cilët njëri prej tyre të jetë profili trajtim ujrash.
- 1)Inxhinier Kimist /Procese teknologjike
- 1)Inxhinier IT

Punonjësit e sipërcituar të cilët të figurojnë në listepagesat e shoqërisë të paktën për gjashtë muajt e fundit të shoqëruar me kontratë pune , Diploma, licensa

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

1. Inxhinier Gjeodet

Inxhinieri Gjeodet është i nevojshëm në kolaudim për të verifikuar saktësinë e pozicionimit gjeometrik të objektit, kuotat altimetrike, shtrirjen në terren dhe përputhjen e tyre me projektin. Pjesëmarrja e tij garanton që punimet janë realizuar brenda tolerancave të lejuara teknike.

2. Inxhinier Ndërtimi / Profili Strukturist

Prania e Inxhinierit Strukturist është e domosdoshme për të vlerësuar sigurinë strukturore të objektit, stabilitetin e elementëve mbajtës dhe zbatimin korrekt të zgjidhjeve strukturore. Ai garanton që struktura përmbush kërkesat e rezistencës, qëndrueshmërisë dhe jetëgjatësisë sipas standardeve në fuqi.

3. Inxhinier Hidroteknik

Pjesëmarrja e Inxhinierit Hidroteknik është thelbësore për kolaudimin e sistemeve të furnizimit me ujë, kanalizimeve, shkarkimeve dhe elementëve hidraulikë. Ai vlerëson funksionalitetin, kapacitetin, hermeticitetin dhe eficiencën e sistemeve hidroteknike, duke garantuar përdorim të sigurt dhe të qëndrueshëm.

4. Inxhinier Elektrik

Inxhinieri Elektrik duhet të jetë pjesë e procedurës së kolaudimit për të verifikuar instalimet elektrike, pajisjet, sistemet e mbrojtjes dhe përputhjen e tyre me standardet e sigurisë. Prania e tij garanton funksionimin korrekt, sigurinë elektrike dhe eliminimin e rreziqeve për personelin dhe përdoruesit.

5. Inxhinier Mekanik

Pjesëmarrja e Inxhinierit Mekanik është e domosdoshme për kolaudimin e pajisjeve mekanike, pompave, agregateve dhe sistemeve të lëvizshme. Ai verifikon instalimin, funksionimin, performancën dhe përputhjen e pajisjeve me specifikimet teknike dhe kontraktuale.

6. Inxhinier Mjedisi

Inxhinieri i Mjedisit është i nevojshëm për të garantuar që objekti dhe proceset e kolauduara përmbushin kërkesat mjedisore, standardet ligjore dhe kushtet e lejes mjedisore. Ai vlerëson ndikimin në mjedis dhe masat e marra për mbrojtjen e tij gjatë dhe pas realizimit të projektit.

7. Inxhinier Kimist / Procese Teknologjike

Prania e Inxhinierit Kimist është e domosdoshme për verifikimin e proceseve teknologjike, trajtimit të ujit/fluideve, dozimit të kimikateve dhe cilësisë së produkteve përfundimtare. Ai garanton që proceset funksionojnë sipas parametrave teknikë dhe standardeve të cilësisë.

8. Inxhinier IT

Inxhinieri IT duhet të jetë pjesë e procedurës së kolaudimit për të verifikuar sistemet informatike, automatizimin, monitorimin, SCADA-n dhe integrimin e pajisjeve dixhitale. Prania e tij siguron funksionimin korrekt të sistemeve të kontrollit, sigurinë e të dhënave dhe vazhdimësinë e operimit.

2.5 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër të gjitha shpenzimet në përfundim të kolaudimit për të kryer të gjitha analizat e nevojshme për garantimin e cilësisë së ujit. Përbushja e të gjitha standarteve higjieno-sanitare duhet të garantohet nga laborator të akredituar sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të siguruar se operatori do të përbushë kërkesat e AK

Kërkesa që operatori ekonomik të marrë përsipër të gjitha shpenzimet për kryerjen e analizave të nevojshme pas përfundimit të kolaudimit është teknikisht dhe ligjërish e domosdoshme, pasi cilësia e ujit përbën një element kritik të sigurisë publike dhe shëndetit të konsumatorëve.

Kryerja e analizave fiziko-kimike dhe mikrobiologjike është e nevojshme për të verifikuar që sistemi i furnizimit me ujë funksionon në mënyrë korrekte dhe se uji i prodhuar dhe i shpërndarë përbush kërkesat e standardeve higjieno-sanitare në fuqi. Këto analiza shërbejnë për të garantuar që gjatë fazës së ndërtimit, instalimit dhe kolaudimit nuk janë krijuar ndotje, devijime teknologjike apo rreziqe për cilësinë e ujit.

Detyrimi që analizat të kryhen nga laboratorë të akredituar siguron besueshmërinë, saktësinë dhe vlefshmërinë ligjore të rezultateve, në përputhje me aktet nënligjore dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare për kontrollin e cilësisë së ujit. Kjo kërkesë garanton transparencë, objektivitet dhe shmang çdo konflikt interesi, duke siguruar që kolaudimi përfundimtar të mbështetet në të dhëna të verifikuara teknikisht.

Marrja përsipër e këtyre shpenzimeve nga operatori ekonomik është e justifikuar teknikisht, pasi analizat përbëjnë pjesë përbërëse të procesit të kolaudimit dhe janë të domosdoshme për pranimin përfundimtar të objektit. Kjo siguron që autoriteti kontraktor të pranojë vetëm sisteme që përbushin plotësisht kërkesat e cilësisë dhe sigurisë, duke garantuar furnizim të sigurt dhe të qëndrueshëm me ujë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në të gjitha rastet kur përmendet çertifikatë ,markë,emër i veçantë ,patentë,vizatim ose tip,origjine specifike,prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.